



## **Deklaratë e stafit të FMN-së në Përfundim të Konsultimeve për Nenin IV dhe Misionit të Rishikimit të Marrëveshjes PRGF-EFF në Shqipëri, 13 Maj 2008**

*Kjo deklaratë paraqet përfundimet e misionit të FMN-së që vizitoi Shqipërinë për konsultimet për nenin IV dhe bisedimet për rishikimin e pestë në kuadrin e marrëveshjes së PRGF-EFF. Misioni u përqëndrua në rishikimin e mesvitet të buxhetit të 2008, si dhe në masat për të përmirësuar financat e KESH-it.*

### **Shqipëria ka bërë një përparim ekonomik mbresëlënës gjatë dekadës së fundit.**

Prodhimi kombëtar bruto (PBB) për frymë i shprehur në dollarë është më shumë se dyfishuar, ndërsa inflacioni është mbajtur i ulët. Këto faktorë, së bashku me dërgesat e larta të emigrantëve, kanë përmirësuar ndjeshëm kushtet sociale. Ky përparim i madh i detyrohet politikave të matura makroekonomike dhe politikave strukturore që kanë rritur produktivitetin dhe investimet dhe kanë kontribuar në stabilitetin e bilancit të pagesave.

**Përparimi ekonomik i shpejtë mund të vazhdojë, në rast se disa probleme të rrënjësura thellë adresohen me vendosmëri.** Në mënyrë të veçantë, sektori i energjisë elektrike që operon me humbje, përbën një rrezik të madh për buxhetin dhe ul potencialin e rritjes ekonomike, ndërsa në vija më të përgjithshme, mjedisi i biznesit kërkon përmirësime për të tërhequr investimet cilësore që nevojiten.

**Rreziqet fiskale do të duhet të adresohen me vendosmëri.** Rritja e bollshme e të ardhurave duhet përdorur për të konsoliduar financat publike dhe për të mbajtur defiçitin e buxhetit në 5.2 përqind të PBB-së. Duke qenë se disa rreziqe fiskale mbeten—p.sh. tejkalimi i kostonë në rrugën Rrëshen-Kalimash dhe situata e keqe financiare e KESH-it—planet e Ministrisë së Financave për të mbajtur fonde kontigjence të mjaftueshme janë të mirëpritura.

**Në përfundim të programit me FMN-në, buxheti duhet të ankorohet fort dhe të ulë borxhin në raport me PBB-në, të rrisë besueshmërinë dhe transparencën.** Kjo çështje bëhet edhe më urgjente në një kohë kur Shqipëria do të fillojë të marrë hua në tregjet ndërkombëtare të kapitalit. Ne i inkurajojmë autoritetet të miratojnë një rregull formal fiskal—qoftë i bazuar në shpenzimet, qoftë në defiçit—më e mira do ishte duke filluar që nga buxheti i 2009. Përforcimi i kapaciteteve në menaxhimin e borxhit është gjithashtu i rëndësishëm.

**Presionet globale mbi inflacionin kërkojnë kujdes dhe vigjencë.** Tregjet financiare ndërkombëtare mbeten të pastabilizuara, rritja e partnerëve tregtarë është duke u ngadalësuar dhe çmimet botërore të mallrave bazë kanë arritur nivele rekord. Megjithatë, falë politikave të matura buxhetore dhe monetare, inflacioni në Shqipëri parashikohet të mbahet në 4 përqind në 2008, më i ulët se në vendet e tjera të rajonit. Për këtë arsye është shumë e rëndësishme të evitohen presionet e brendshme ndaj kërkesës. Në mënyrë të veçantë, ndërsa ndihma ndaj të varfërve për të kompensuar efektet e çmimeve të rritura të



ushqimeve dhe të energjisë është e drejtë, rritjet reale të rrogave në sektorin publik duhet të kufizohen fort, për të shmangur nxitjen e një spiraleje paga-inflacion.

**Ndihmuar nga politika të matura fiskale, politika monetare mund të synojë të ankorojë pritjet për inflacionin dhe të ruajë stabilitetin financiar.** Banka e Shqipërisë duhet të vazhdojë të jetë gati për t'iu përgjigjur çdo efekti të raundit të dytë nga presionet globale të çmimeve, përfshirë këtu edhe me rritje të mëtejshme të normave të interesit. Përfundimi i regjistrimit të krevide kohët e fundit, është një hap i madh përpara për të ruajtur stabilitetin financiar. Forcimi proaktiv i mbikqyrjes dhe kuadrit rregullator duhet të ndihmojë në ngadalësimin e rritjes së krevide dhe duhet ndjekur në mënyrë të vazhdueshme. Miratimi i amendamenteve përkatëse të Kodit Civil është kyç për një ekzekutim më të mirë të kolateralit.

**Ndërsa axhenda e privatizimit të KESH-it është duke ngjallur interesim të mirëpritur, pozicioni financiar i kompanisë mbetet i dobët.** Rritja e tarifave prej 20 përqind në mars ndihmoi financat e kompanisë, po ashtu siç kanë ndihmar edhe rreshjet e mbara. Për më tepër, në bashkëpunim me Bankën Botërore, planifikohen përmirësime ambicioze në mbledhjen e të ardhurave dhe reduktimin e vjedhjeve. Megjithatë, me ecurinë aktuale, humbja indirekte e financave publike do të shkojë në rreth 1.4 përqind të PBB-së. Kjo është më shumë se gjysma e shpenzimeve publike për shëndetësinë dhe thekson nevojën urgjente për masa korrigjuese. KESH-i duhet të reduktojë importet, të mbajë në fre kostot e personelit dhe të prioritarizojë investimet brenda një buxheti më të vogël nëse do të evitohet rritje të mëtejshme të tarifave.

**Reformat strukturore duhet të bëjnë një tjetër hap përpara.** Veprimet e fundit për të lehtësuar barrën rregullative janë të rëndësishme. Megjithatë, të drejtat e pronësisë, zbatimi i kontratave, qeverisja dhe sistemi gjyqësor mbeten dobësitë kryesore. Reformat në prokurimin publik kërkojnë zbatim më të gjerë, ndërsa shtrirja, shpeshtësia dhe cilësia e statistikave duhet të përmirësohet, sidomos përsa i përket llogarive kombëtare. Duhet bërë kujdes që INSTAT-it do t'i akordohen fonde të mjaftueshme për të zbatuar përmirësimet e nevojshme.

Misioni dëshiron të falenderojë autoritetet për bashkëpunimin e shkëlqyer dhe mikpritjen e ngrohtë.

Gerwin Bell  
Shef Misioni

K. Ann-Margret Westin  
Përfaqësuese e Përhershme